





HEALTH  
EDUCATION  
STUDIO

**myosa**<sup>®</sup>  
MYOFUNCTIONAL SLEEP APPLIANCE

## DIAGNOSTIKIMI DHE TRAJTIMI I RRUGËVE TË FRYMËMARRJES DHE ÇRREGULLIMET E NYJES TEMPOROMANDIBULLARE



 **TMD**



# Sistemi myOSA për fëmijë dhe të rritur

Paraqet gamën e aplikatorëve intraoralë funksionalë të dizajnuar për trajtimin e frymëmarrjes së çrregulluar gjatë gjumit (SDB) dhe çrregullimet e nyjes temporomandibulare (TMJ). Përveq lirimit nga presioni i simptomeve të SDB-së, gama e aplikatorëve myOSA të krijuar nga industria australiane lidere edhe për sistemin e suksesshëm Myobrace, Myofunctional Research Co. trajton rrugët e sipërme të frymëmarrjes dhe mosfunksionimin e neuromuskujve, që njihen si shkaktarë të SDB-së.

Kjo gamë përfshinë aplikatorë për trajtimin e frymëmarrjes së çrregulluar gjatë gjumit duke filluar nga moshë dy vjeçare e deri tek moshat e rritura, me fokus në aplikatorët specialë për trajtimin e Bruksizmit dhe çrregullimeve të TMJ. Frymëmarrja e çrregulluar gjatë gjumit SDB tek të rriturit zakonisht manifestohet si gërhitje, e cila është pasojë e bllokimit të kanaleve të frymëmarrjes qoftë nazale apo orale, gjatë gjumit. Nëse ky bllokim apo kjo pengesë e qarkullimit të ajrit është pasojë e problemeve nga moszhvillimi i muskujve për rreth fytyrës apo nofullave, atëherë dalin në pah shumë shkaktarë të tjerë të gërhitjes.

Ndër shkaktarët më të zakonshëm janë frymëmarrja orale kronike, dietat e gabuara, obeziteti dhe zhvillimi i pamjaftueshëm i nofullave. Për më tepër, trajtimet ortodontike dhe nxjerrjet e dhëmbëve e bëjnë edhe më të theksuar gërhitjen.


## myOSA for juniors and myOSA for kids

Shkaktarët e çrregullimit të frymëmarrjes gjatë gjumit (SDB), mund t'i gjejmë fare lehtë qysh në fëmijërinë e hershme. Nëse këta shkaktarë nuk identifikohen me kohë, frymëmarrja e çrregulluar gjatë gjumit mund të rezultojë më vonë me probleme dhe çrregullime të shumta si: bajamet dhe adenoidet e zmadhuara, vështirësitë në mësimnxënie si dhe me probleme në sjelljet e fëmijut. Duke pasur target rrugët e sipërme të frymëmarrjes, myOSA për parashkollorë dhe myOSA për fëmijë korrigojnë frymëmarrjen e çrregulluar gjatë gjumit duke i adresuar problemet në rrugët e sipërme të frymëmarrjes dhe mosfunksionimin e neuro muskujve, që shkaktojnë SDB-në.

Pasojat e frymëmarrjes së çrregulluar gjatë gjumit tek fëmijët arrijnë deri tek problemet serioze me shëndetin e përgjithshëm, me zhvillimin mendor, sjelljet e çakorduara, përfshirë edhe vështirësitë në të koncentruar gjatë orës mësimore. Për më tepër, përveq pasojave në zhvillimin facial, zhvillimin e dhëmbëve dhe të nofullave, mosadresimi i shkaktarëve të SDB, krijon kufizime të mëdha në potencialin personal pas fazës së fëmijërisë. Pra, duke u fokusuar në trajtimin e problemeve në rrugët e sipërme të frymëmarrjes dhe në mosfunksionimin e neuro muskujve, si shkaktarë të SDB-së, gama e aplikatorëve myOSA për fëmijë bënë që të gjitha këto probleme të jene sa më jetëshkurtër.

Koncepti myOSA përmes aplikatorëve inovativë oralë dhe bazuar në rekomandimet profesionale medicinale dhe dentare, garanton trajtimin e suksesshëm të frymëmarrjes së çrregulluar gjatë gjumit dhe trajtimin e problemeve me nyjen temporomandibulare (TMJ).

STM **STAGE 1 - MOULDABLE**  
MOUTH BREATHER VERSION



Nyja temporomandibulare  
në gjendje normale



Myosa® FOR JUNIORS 2-6 years




Myosa® FOR KIDS 6-12 years



## myOSA for snorers

Përfshinë aplikatorët e dizajnuar për personat që gërhitin dhe për ata që marrin frymë me gojë gjatë gjumit. Këta aplikatorë veprojnë duke avansuar përpara nofullën e poshtëme gjatë gjumit përmes korigjimit të pozicionit të gjuhës dhe stimulimit të kafshimit të hapur, që afektojnë pozitivisht hapjen e kanaleve të frymëmarrjes. 'myOSA for snorers S1' është i dizajnuar nga materiali fleksibil i cili atakon nofullat në mënyrë gjentile dhe është jashtëzakonisht i adaptueshëm për personat me dhimbje në nyjen temporomandibulare. 'myOSA for snorers S2' është i dizajnuar ekskluzivisht për gërhitësit të cilët nuk vuajn nga frymëmarrja orale kronike, ose për personat që tashmë kanë përfunduar përdorimin e aplikatorit S1. Ky aplikator ka të njëjtat veqori funksionale si S1, por është më adaptil, si dhe gjithashtu zhvillon nofullën e poshtëme gjatë gjumit dhe hapë kafshimin. Duke trajtuar frymëmarrjen e pamjaftueshme me hundë, S2 optimizon dhe rregullon frymëmarrjen duke stimuluar dhe rritur frymëmarrjen nazale.

**S2** STAGE 2 - NON-MOULDBLE  
PARTIAL NOSE BREATHER VERSION



**S3** STAGE 3 - NON-MOULDBLE  
ESTABLISHED NOSE BREATHER VERSION



## myOSA for TMJ

Çrregullimet e nyjes temporomandibulare (TMJ) paraqesin problem kompleks të shfaqur përmes një mori simptomesh, të cilat kërkojnë një mori filozofishë trajtimi. Këto çrregullime rëndom ndërlihen me çrregullimet e frymëmarrjes gjatë gjumit, derisa modalitetet e gabuara të trajtimit mund ta rëndojnë edhe më shumë gjendjen. Gama e aplikatorëve për çrregullimet e TMJ është dizajnuar për të lehtësuar diagnostikimin e menjëhershëm dhe lirim nga simptomet, qysh në vizitën e parë të pacientit. Meqenëse çrregullimet e TMJ afektojnë dhëmbët, muskujt facialë dhe regjionin për rreth nyjes, aplikatori përkatës vepron duke shkarkuar presionin nga nyja temporomandibulare dhe duke spostuar mandibullën në klasin I, pa anashkaluar trajtimin e frymëmarrjes me gojë, shprehitë e dëmshme orale dhe Bruksizmin.

Në këtë kontekst, myOSA ofron dy aplikatorë: myOSA për TMJ i cili përdoret për diagnostikimin dhe trajtimin e çrregullimeve në këtë nyje, dhe aplikatorin TMD i cili karakterizohet me profil ndërtimi të shkurtër, i destinuar për përdorim vetëm gjatë ditës, si dhe nuk e pengon të folurit.

The TMJ Appliance




## myOSA for Teeth Grinders

Shtrengimi i pavullnetshëm i dhëmbëve apo Bruksizmi është një tjetër simptomë që ndërlihet me çrregullimin e frymëmarrjes gjatë gjumit dhe shkaktohet kryesisht nga frymëmarrja orale dhe nga stresi i shtuar. Bruksizmi shkakton dëme të mëdha tek dhëmbët përfshirë sipërfaqen e smaltit, plasaritjen e dhëmbëve apo lëvizshmërinë e tepruar të dhëmbëve. Derisa gama e aplikatorëve myOSA ofron mbrojtje të përgjithshme nga dëmet e bruksizmit, 'myOSA for teeth grinders' është e dizajnuar në mënyrë specifike për mbrojtje dhe trajtim të plotë të bruksizmit, duke mundësuar kontakt gjentil ndërmjet dhëmbëve. Përdorimi dhe adaptimi i këtyre aplikatorëve është i lehtë dhe nuk rrezikon aspak denticionin. 'myOSA for teeth grinders' disponon dy lloje të aplikatorëve: TG i cili është i destinuar për personat të cilët vuajnë nga bruksizmi, por që nuk kanë simptome të çrregullimit të nyjes temporomandibulare, dhe TGH i cili aplikohet për trajtimin e bruksizmit të shoqëruar me dhimbje në nyjen temporomandibulare.



**TG**  
SOFT VERSION

**TGH**  
HARD VERSION



**myosa**<sup>®</sup>

MYOFUNCTIONAL SLEEP APPLIANCE  
SLEEP WELL NATURAL WAY



HEALTH  
EDUCATION  
STUDIO

Rr. Shefqet Shkupi, Bll. B4, Nr. 10,  
Kalabri, 10000 Prishtinë, Kosovë

T: +383 49 848 577

+383 44 453 264

E: [info@healthedu.studio](mailto:info@healthedu.studio)

[www.healthedu.studio](http://www.healthedu.studio)